

**Drejtuar:** Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, Z. Edi Rama, dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

**Data:** 16/09/2025

**Subjekti:** Deklaratë për vendosjen e Rinisë prioritet strategjik në qeverinë e re

I nderuar Kryeministër, I nderuar Kryetar i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë,

Në vitin 2013 ne përshëndetëm përfshirjen e rinisë si fushë prioritare në veprimtarinë e qeverisë, në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, më pas në Ministrinë e Arsimit, Rinisë dhe Sportit dhe më tutje krijimin e Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët në vitin 2021. Hapa që sollën përmirësimin e politikave që mbrojnë të drejtat e të rinjve dhe fëmijëve dhe promovonin pjesëmarrjen e tyre të drejtëpërdrejtë në shoqëri, duke e parë rininë si grup ndërsektorial në zhvillimin e të gjithë politikave.

Shpallja dhe miratimi i qeverisë së re, ka shqetësuar shumë aktorë rinorë dhe organizata pasi konstatojmë se nuk është parashikuar një portofol i dedikuar për rininë në asnjë prej ministrive. Ky fakt rrezikon që prioritetet rinore të fragmentohen duke humbur vazhdimësinë e politikave të ndërtuara gjatë viteve të fundit.

Të rinjtë në moshë 15–29 përbëjnë 21.3% të popullsisë së Shqipërisë. Ata përfaqësojnë një grup të rëndësishëm të fuqisë punëtore dhe potencial për një të ardhme të qëndrueshme të vendit, duke e bërë pjesëmarrjen e tyre vendimtare për zhvillimin ekonomik, social dhe politik të Shqipërisë. Sfidat e papunësisë (17.9%) dhe emigrimit (80% e të rinjve shprehin dëshirë për të emigruar) tregojnë se politikat rinore duhet të vazhdojnë të jenë të mirëkoordinuara si në nivelin qendror dhe atë vendor duke shënuar ndikime të matshme në jetën e të rinjve.

Nga një perspektivë e politikbërjes, është thelbësore të ruhet vazhdimësia dhe të mos ndërpritet puna është bërë deri tani. Sigurimi i zbatimit dhe monitorimit të planeve rinore ekzistuese, si Strategjia dhe Plani Kombëtar për Rininë 2022–2029 apo Garancia Rinore e financuar nga BE, duhet të jenë po aq të rëndësishme sa hartimi i planeve të reja që përmirësojnë lëvizshmërinë, strehimin dhe qëndrimin e rinisë në vend.

Për këto arsye, ne kërkojmë që:

1. Rinia të ketë një portofol të qartë dhe të dedikuar në qeveri;
2. Të ruhet gjithë puna e bërë deri tani dhe të ndërtohet mbi bazën e saj;
3. Rinia të mbetet prioritet i qartë strategjik i qeverisë së re.

Ne besojmë që ruajtja e fokusit të qartë mbi rininë do të kontribuojë në adresimin e sfidave të rëndësishme dhe që politikat rinore të jenë të koordinuara dhe të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Me respekt,

Lista e organizatave pjesëmarrëse:

Rrjeti i Profesionistëve të Rinj